

VENDIM
Nr.290, datë 14.4.2011

**PËR KALIMIN E OBJEKTEVE TË ISH-FABRIKËS SË QELQIT, ZONA
KADASTRALE NR.8230, TIRANË, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRI SË
PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE,
ME QËLLIM PRIVATIZIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, si dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e objekteve të mbetura të paprivatizuara, me nr. pasurie 2/20, 2/27, 2/31 dhe 2/32, zona kadastrale nr.8230, Tiranë, të kthyer në mjedise banimi, pranë ish-Fabrikës së Qelqit, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në përgjegjësi administrimi të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, sipas gentplanit dhe planimetrive bashkëlidhur, me qëllim privatizimin në favor të banorëve posedues, të cilët banojnë në këto godina, por që nuk e kanë bërë privatizimin.

2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të lidhë kontratat e privatizimit me banorët, të cilët banojnë në këto objekte, sipas listave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe kushteve të parashikuara në udhëzimin nr.22, datë 12.10.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha